



Lajmëtari informativ i Qytetit të Shkupit

Numër
falas


SHKUPI

DHJETOR 2015

Rrethrrrotullimi i ri në Porta Vlae



Bulevardi "Mitropolit Teodosij Gologanov" - pjesa e 3-të



Korsia e biçikletave - bulevardi
«Aleksandar Makedonski»

PËR
SHKUPIN

**BILANCI PËR
VITIN 2015**



U rregullua parku «Maqedonia» -
pjesa e 2-të

U ndërtua mbikalim i ri
në Hipodrom



Garazhi me kate "Todor Aleksandrov"





Të nderuar bashkëqytetarë,

Në dorë mbani edicionin më të ri të Lajmëtarit informativ „SHKUPI” i cili u kush-tohet projekteve që i premtoi dhe realizoi Qyteti i Shkupit, në vitin 2015. Në fund të vitit është e natyrshme që të bëhet një përmbledhje e asaj që është punuar, por edhe të bëjmë të ditur projektet e planifikuara, të cilave do t’u përkushtohemi në vitin 2016.

Si rezultat i bashkëpunimit të mirë me Ju, të nderuar bashkëqytetarë, gjatë vitit 2015, Qyteti i Shkupit realizoi projekte të shumta në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Ndërtuam rrethrotullime, zgjeruam rrugët kryesore dhe bulevardet, punuam në përmirësimin e infrastrukturës së çiklizmit në qytet, investuam në elektromobilitetin dhe në gazifikimin e shkollave të mesme, ngritëm sipërfaqe të reja gjelbërimi, përmirësuar higjienën publike nëpërmjet vendosjes së kontejnerëve nëntokësorë, organizuam manifestime sportive dhe kulturore me cilësi.

Jam veçanërisht krenar për projektet e mëposhtme: ndërtuam rrethrotullimin më të madh në Shkup, në kryqëzimin ndërmjet bulevardit “Partizanski odredi” dhe rrugëve “Gjorçe Petrov” dhe “Aco Shopov”, tek Porta Vllae; zgjeruam pjesën e tretë të bulevardit “Mitropolit Teodosij Gologanov” dhe rrugën “Jordan Mijalkov”; për të rritur sigurinë e këmbësorëve

ndërtuam mbikalimin i cili lidh lagjet Hipodrom dhe Inxhikovë; në autobusët e NQP-së vendosëm sistemin e ri të pagimit të biletave; përgjatë bulevardëve, në parqe dhe në oborret e shkollave të mesme mbollëm 9.500 fidanë, në dy aksione – pranveror dhe atë të vjeshtës...

Lu përkushtuam në mënyrë të veçantë realizimit të projektit për përmirësimin e infrastrukturës së çiklizmit dhe rritjes së sigurisë së çiklistëve në qytet – SHKUPI QYTETI I BIÇIKLETAVE 2017. Si pjesë e rrugës 1 të këtij projekti të ndërlikuar ndërtuam dhe rinovuam mbi 8.000 metra korsi biçikletash. Punët ndërtimore në rrugën 1 janë para përfundimit, gjë me të cilën do t’u mundësojmë çiklistëve lëvizje të pandërprerë nga Gazi Baba, nëpërmjet qendrës së qytetit, deri në Karposh.

Qyteti i Shkupit edhe në vitin 2016 do të punojë në projekte të mëdha infrastrukturore, me të cilat do të tejkalohen problemet e shumta shumëvjeçare dhe, që do të përmirësojnë jetesën e qytetarëve. Një pjesë e këtyre projekteve tashmë kanë filluar dhe do të përfundojnë pikërisht në vitin 2016. Ndërmjet tyre do të ndajë: në Komunën e Sarajit do të rikonstruktohet rruga kryesore Saraj dhe rrugët në fshatin Glumovë; në Komunën Gjorçe Petrov do të zgjerohet bulevardin “Partizanski odredi” deri tek rrethrotullimi tek kisha „Shën Pjetri dhe Pali” dhe do të vazhdojmë projektin për depërtimin e grykës së ngushtë në rrugën “Boris Sarafov”; në Komunën Karposh do të ndërtojmë rrethrotullim tek Hubo Market, në bulevardin “8 Septemvri” dhe kanalizimin e ujërave të zeza në rrugën Moskovska; në Komunën Qendër do të zgjerohet një pjesë të rrugës “Todor Aleksandrov” dhe do të rikonstruktojmë

rrugën “Dimitar Vlahov”, si dhe një pjesë të sheshit para kishës „Shën Marija”; në Komunën Kisela Voda do të punojmë në fazën e tretë të bulevardit “Boris Trajkovski”, në drejtimin nga fabrika „Staklarnica” tek lagja Draçevë, në zgjatimin e bulevardit “Serbia” deri në rrugën “Hristo Tatarçev”, ku do të ndërtohet një rrethrotullim i madh dhe në zgjerimin e rrugës “Pavel Shatev”; në Komunën Aerodrom do të përfundojmë fazën e dytë të projektit të bulevardit “Treta makedonska brigada”, nga kryqëzimi me rrugën “Vasko Karangelevski” deri në rrugën “Nikolla Karev”, do të ndërtojmë bulevardin “ASNOM” në pjesën nga Keramidnica deri në sallën e re „Jane Sandanski” dhe një pjesë të bulevardit “ASNOM” nga stacioni i fundit i autobusit numër 5-së deri tek shtëpitë në Lisiçe – faza e parë; në Komunën Gazi Baba do të përfundojmë fazën e parë të projektit për zgjerimin dhe rikonstruksionin e rrugës “Maxhari”, do të bëjmë ndërtime plotësuese tek rrethrotullimi ndërmjet rrugëve “16. Makedonska brigada” dhe “Koçe Metalec” tek lagja Hekurana, dhe do të punojmë në zgjerimin e bulevardit “Aleksandar Makedonski” nga „Agroservis” deri në kryqëzimin me nivele “Dijamant”; në Komunën e Çairit do të punojmë në rikonstruksionin dhe zgjerimin e bulevardit “Hristijan Todorovski Karposh” në pjesën e Çairit, si dhe në ndërtimin e korsisë së 4-të të bulevardit “Nikolla Karev”; në Komunën Butel do të depërtojmë bulevardin “Hristijan Todorovski Karposh” drejt unazës dhe do të ndërtojmë plotësisht kanalizimin atmosferik të rrugëve “Aleksandar Urdarevski” dhe “Boca Ivanova”; në Komunën Shuto Orizare do të ndërtojmë plotësisht ujësjellësin e ri.

Në bashkëpunim me JU, të nderuar bashkëqytetarë, edhe në vitin 2016 do të ofrojmë zgjidhje të shumta cilësore për problemet urbane dhe do të punojmë me përkushtim në përmirësimin e jetesës në kryeqytet.

Koçe Trajanovski
Kryetar i Qytetit të Shkupit



„SHKUPI”

LAJMËTARI INFORMATIV I
QYTETIT TË SHKUPIT

Numri i parë i lajmëtarit informativ
„Shkupi” u botua më:
10 dhjetor 2008

Redakton

Seksioni për marrëdhënie me publikun
i Qytetit të Shkupit

www.skopje.gov.mk

Përkthyes dhe lektor

Vladimir Bogdanovski

BOTON QYTETI I SHKUPIT

Bulevardi Ilinden 82

Telefon

02 3297 255

e-mail adresa

gragjani@skopje.gov.mk

Dizajni/Botol:

Nampres, Shkup

Në bulevardin “Partizanski odredi”, tek Porta Vllae

U NDËRTUA RRETHRROTULLIMI MË I MADH NË SHKUP



PASTAJ



MË PARË

Në kryqëzimin e bulevardit “Partizanski odredi” dhe rrugëve “Aco Shopov” dhe “Gjorçe Petrov”, tek Porta Vllae, në maj të vitit 2015 u ndërtua rrethrotullimi më i madh në Shkup, kurse bulevardi “Partizanski odredi” u zgjerua deri në autobazën e NQP “Gjorçe Petrov”. Zgjidhja e re e komunikacionit rrugor tek Porta Vllae kontribuoi në rritjen e sigurisë në zhvillimin e komunikacionit rrugor në këtë pjesë të qytetit, në lehtësimin e lëvizjes drejt daljes nga Shkupi, si dhe në rregullimin e hapësirës.

jtëse me gjerësi 1,5 metra dhe gjelbërim i mesëm. Rrethrotullimi përbëhet nga dy korsi rrugore. Nëpër rrethrotullim, shikuar në drejtim të Gjorçe Petrov, bulevardi “Partizanski odredi” është zgjeruar deri në hyrjen në autobazën e NQP-së. Me zgjerimin, bulevardi u bë me tre korsi rrugore në çdo drejtim, zhardinierë të mesme, korsi për biçikleta dhe këmbësorë. Gjatë punëve ndërtimore është kryer edhe rikonstruksioni i 100 metrave nga rruga “Gjorçe Petrov” dhe 162 metra nga

- Në kryqëzimin ndërmjet bulevardit “Partizanski odredi” dhe rrugëve “Aco Shopov” dhe “Gjorçe Petrov” është formuar rrethrotullimi më i madh në Shkup, me diametër 40 metra, rrugë automobilistike me gjerësi 9 metra, korsi mbrojtës me gjerësi 1,5 metra dhe gjelbërim i mesëm. Rrethrotullimi përbëhet nga dy korsi rrugore. Nëpër rrethrotullim, shikuar në drejtim të Gjorçe Petrov, bulevardi “Partizanski odredi” është zgjeruar deri në hyrjen në autobazën e NQP-së. Me zgjerimin, bulevardi u bë me tre korsi rrugore në çdo drejtim, zhardinierë të mesme, korsi për biçikleta dhe këmbësorë. Gjatë punëve ndërtimore është kryer edhe rikonstruksioni i 100 metrave nga rruga “Gjorçe Petrov” dhe 162 metra nga

rruga “Aco Shopov”, në pjesët që hyjnë në rrethrotullim. Për largimin e ujërave atmosferik nga rrethrotullimi i ri është ndërtuar kanalizim atmosferik, me gjatësi të përgjithshme 472 metra. Për punët ndërtimore për zgjerimin e bulevardit “Partizanski odredi” deri në autobazën e NQP-së në Gjorçe Petrov dhe për ndërtimin e rrethrotullimit tek Porta Vllae, Qyteti i Shkupit shpenzoi 50,5 milioni denarë. Zgjidhja e re e komunikacionit rrugor tek Porta Vllae ndriçohet nga 13 shtylla për ndriçim rrugor, me 32 llamba, kurse Qyteti i Shkupit për këtë pjesë të projektit investoi 885.799 denarë. Tek rrethrotullimi i ri ndërtuar në bulevardin “Partizanski odredi” është rregulluar gjelbërimi me sipërfaqe të përgjithshme 4.604 metra katrorë, gjë për të cilën janë shpenzuar rreth 2 milion denarë. Me këtë, vlera e përgjithshme e projektit për ndërtimin e rrethrotullimit tek Porta Vllae dhe zgjerimin e bulevardit “Partizanski odredi” deri në autobazën e NQP-së në Gjorçe Petrov është 53,4 milion denarë – thotë kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski.

KATËR KORSI EDHE PËR PJESËN E TRETË TË BULEVARDIT "MITROPOLIT TEODOSIJ GOLOGANOV"



Bulevardi "Mitropolit Teodosij Gologanov" në maj të vitit 2015 u bë me katër korsi rrugore edhe në drejtimin nga kryqëzimi me bulevardin "8 Shtetevri" deri në rrugën "Moskovska".

- Zgjerimi dhe rikonstruksioni i pjesës

së tretë të bulevardit "Mitropolit Teodosij Gologanov" është edhe një projekt kapital i Qytetit të Shkupit i cili mundësoi zhvillimin më të sigurt të komunikacionit rrugor, zvogëlimin e kaosit dhe shkurtimin e kohës së udhëtimit. Me zgjerimin, në këtë pjesë të bulevardit, me

gjatësi 1.600 metra, janë formuar katër korsi rrugore, nga dy në çdo drejtim. Nga të dyja anët e rrugës automobilistike të zgjeruar janë ndërtuar trotuare, të shtruara me elemente pauer. Punët ndërtimore u shfrytëzuan për vendosjen e kanalizimit të ri atmosferik me gjatësi të përgjithshme 1.493 metra dhe për rikonstruksionin e rrjetit ekzistues të ujërave të zeza. Qyteti i Shkupit për punët ndërtimore në këtë pjesë shpenzoi rreth 81 milion denarë. Pjesa e tretë e bulevardit të zgjeruar "Mitropolit Teodosij Gologanov" ndriçohet nga 82 shtylla për ndriçim rrugor në të cilat janë vendosur 108 llamba, dhe për këtë punë Qyteti i Shkupit ndau rreth 11,6 milion denarë. Me këtë, vlera e përgjithshme e projektit për zgjerimin dhe rikonstruksionin e bulevardit "Mitropolit Teodosij Gologanov" është 92,6 milion denarë – sqaron kryetari Koce Trajanovski.

U ZGJERUA RRUGA “JORDAN MIJALKOV”

Rruga “Jordan Mijalkov” gjatë verës së vitit 2015 u zgjerua dhe u rikonstruktua nga kryqëzimi me rrugën “German” deri në kryqëzimin me rrugën “Pavel Shatev”.

- Me zgjerimin, kjo rrugë e mëparshme e ngushtë dhe jofunksionale u bë me tre korsi me gjerësi nga 3,25 metra në gjatësi 750 metra, korsi rrugore servisi me parking me gjerësi 6 metra dhe gjatësi 200 metra dhe trotuar të shtruar me pllaka begatoni. Rikonstruksioni i rrugës “Jordan Mijalkov” u shfrytëzua për të vendosur kanalizim të ri at-

PASTAJ



MË PARË



mosferik, dhe u realizua edhe rikonstruksioni i rrjetit të ujërave të zeza. Qyteti i Shkupit për punët ndërtimore të kësaj rruge automobilistike investoi rreth 43 milion denarë. Rruga e re e zgjeruar ndriçohet nga 19 shtylla për ndriçim në të cilat janë vendosur 32 llamba, kurse Qyteti i Shkupit për këtë punë ndër-

timore shpenzoi rreth 2 milion denarë. Me këtë, vlera e përgjithshme e projektit për zgjerimin dhe rikonstruksionin e rrugës “Jordan Mijalkov”, nga kryqëzimi me rrugën “German” deri para kryqëzimit me rrugën “Pavel Shatev” është rreth 45 milion denarë – thotë kryetari Koce Trajanovski.

RRETHRROTULLIM DO TË LIDHË RRUGËT “16. MAKEDONSKA BRIGADA” DHE “KOCE METALEC”

Rrethrotullim do të lidhë rrugët “16. Makedonska brigada” dhe “Koce Metalec”, në lagjen Autokomandë, në komunën Gazi Baba. Në terren tashmë është vendosur kanalizimi atmosferik, kurse këto ditë po punohet në mënyrë intensive edhe në pjesët e rrugëve që hyjnë në këtë rrethrotullim.

- Në vendin e kryqëzimit ekzistues me fushëpamje jo të mirë ndërmjet rrugëve “16. Makedonska brigada” dhe “Koce Metalec” do të formohet rrethrotullim me diametër të brezit të gjelbër 60 metra. Në vetë rrethrotullim do të formohen 2 korsi rrugore me gjerësi të përgjithshme 9 metra. Do të kryhet edhe rikonstruksioni i rrugës automobilistike të rrugës “16. Makedonska brigada”, me gjatësi 390 metra, si dhe i një pjese të rrugës “Koce Metalec”, me gjatësi 240 metra. Rreth

rrethrotullimit do të rregullohet trotuar i ri dhe korsi për biçikleta. Gjatë punëve ndërtimore do të kryhet edhe mbrojtja e tubacionit të gazit, dhe do të kryhet edhe rikonstruksioni i rrjetit të ujësjellësit, me gjatësi 52 metra. Në rrethrotullimin e ri ndërmjet rrugëve “16.

Makedonska brigada” dhe “Koce Metalec”, në lagjen Autokomandë, do të vendoset edhe ndriçim i ri rrugor. Qyteti i Shkupit për këtë punë të ndërlikuar ndërtimore do të shpenzojë rreth 45 milion denarë – sqaron kryetari Koce Trajanovski.



FILLOI DEPËRTIMI I BULEVARDIT “HRISTIYAN TODOROVSKI KARPOSH” NË BUTEL

Më 5 dhjetor të vitit 2015 filloi depërtimi i bulevardit “Hristijan Todorovski Karposh” në Butel – faza e parë.

Në fazën e parë, pjesa e re e bulevardit “Hristijan Todorovski Karposh” do të ndërtohet nga kryqëzimi me bulevardin “Bosna i Hercegovina” deri në kryqëzimin me rrugën “Natanail Kuçevishki”, në gjatësi 1.000 metra. Bulevardi i ri përbëhet nga 6 korsi rrugore, korsi për biçikleta dhe këmbësorë nga të dyja anët dhe gjelbërim i mesëm. Në bulevardin e ri “Hristijan Todorovski Karposh” do të vendoset rrjet ujësjellësi dhe kanalizim i ri atmosferik, si dhe kanalizimi i ujërave të zeza. Në bulevard do të vendoset ndriçim i ri rrugor. Për realizimin e fazës së parë të këtij projekti kapital, Qyteti i Shkupit do të ndajë 160

milion denarë ose rreth 2,6 milion euro, kurse për pastrimin e marrëdhënieve të pronësisë juridike të trasesë Qyteti i Shkupit ndau në mënyrë plotësuese 1,6 milioni euro.



EDHE PJESA E DYTË E RRUGËS “TRETA MAKEDONSKA BRIGADA” DO TË KETË PAMJE TË RE

Zgjerimi dhe rikonstrukcioni i pjesës së dytë të rrugës “Treta makedonska brigada”, në Aerodrom, është në vijim. Punët ndërtimore realizohen në drejtimin nga kryqëzimi me rrugën “Vasko Karangelevski” deri në rrugën “Nikolla Karev”, në pjesën me gjatësi 1.400 metra.

Me zgjerimin, kjo rrugë e ngushtë dhe jofunksionale do të ketë 4 korsi rrugore (nga dy në çdo drejtim), brez të gjelbër 1,5 metra, korsi për biçikleta dhe trotuare. Do të ndërtohet edhe gjelbërim i mesëm me gjerësi 5 metra. Punët ndërtimore do të shfrytëzohen për vendosjen e kanalizimit të ri atmosferik me gjatësi të përgjithshme 1.400 metra. Në bulevard do të vendoset ndriçim i ri me 81 shtylla për ndriçim rrugor. Për punët ndërtimore, për dislokimin e instalimeve nëntokësore dhe për ndriçimin e kësaj pjese të zgjeruar Qyteti i Shkupit do të shpenzojë rreth 104 milion denarë – thotë kryetari Koce Trajanovski.



U ZGJERUA NJË PJESË E RRUGËS “CVETAN DIMOV”

Ekipet e Qytetit të Shkupit dhe të NP „Rrugë dhe rrugica” zgjeruan dhe rikonstruktuan 200 metra nga rruga “Cvetan Dimov”, para QT “Çairçanka”. Me këtë punë ndërtimore, rruga ka nga 3 korsi rrugore në çdo drejtim dhe trotuare të reja.

Ky projekt ndërtimor kontribuoi në lehtësimin e zhvillimit të komunikacionit rrugor në këtë pjesë të komunës së Çairit.

PO ZGJEROHET RRUGA MAXHARI ...

Rruga "Maxhari" në komunën Gazi Baba vitin e ardhshëm do të ketë katër korsi rrugore nga kryqëzimi me rrugën "Juzhnomoravski brigadi" deri në rrugën "Palmiro Toliati", në gjatësi 666 metra. Punët ndërtimore për zgjerimin dhe rikonstruksionin e kësaj pjese të rrugës, zhvillohen sipas dinamikës së parashikuar.

- Kjo rrugë e ngushtë dhe jofunksionale do të ketë katër korsi rrugore, nga dy korsi në çdo drejtim, trotuare të reja dhe korsi për biçikleta si dhe ndriçim të ri rrugor. Punët ndërtimore do të shfrytëzohen për të vendosur kanalizim të ri atmosferik nga kryqëzimi i rrugës "Juzhnomoravski brigadi" me rrugën "Metodija Andonov Çento" deri te mbikalimi në Maxhari, i cili do të zgjidhë problemin shumëvjeçar me largimin e ujërave atmosferik - sqaroi kryetari Koce Trajanovski.



Projekti për zgjerimin dhe rikonstruksionin e rrugës "Maxhari" do të realizohet në dy faza. Për fazën e parë të zgjerimit të rrugës "Maxhari", Qyteti i Shkupit do të investojë rreth 52 milion denarë.

... DHE KRYQËZIMI NË RRUGËT "BLAGOJA STEFKOVSKI" DHE "ZHAN ZHOES" NË MAXHARI



Punët ndërtimore për zgjerimin e kryqëzimit të rrugëve "Blagoja Stefkovski" dhe "Zhan Zhores", në lagjen Maxhari, janë para përfundimit.

Rruga "Blagoja Stefkovski" gjatë hyrjes në kryqëzim zgjerohet për të formuar një korsi të veçantë për kthim majtas dhe korsi të veçantë për lëvizje drejtë, nga të dyja anët e kryqëzimit, gjë me të cilën do të mundësohet lehtësimi i komunikacionit rrugor. Për realizimin e këtij projekti Qyteti i Shkupit do të ndajë rreth 4,5 milion denarë.

ASFALT PËR RRUGËN NË SHISHEVË

Me kërkesë të banorëve të Shishevës ekipet e Qytetit të Shkupit rinovuan rrugën kryesore e cila kalon nëpër këtë vendbanim. Rruga është asfaltuar në gjatësi 1.650 metra, kurse Qyteti i Shkupit për këtë punë ndërtimore ndau 8 milion denarë.

Në afërsi të Shishevës është kryer riparimi i shtratit të lumit Treska, gjë për të cilën u ndanë 2 milion denarë në mënyrë plotësuese.

U rinovua edhe rruga automobilistike numër 22, tek stadiumi „Boris Trajkovski” në Maxhari, komuna Gazi Baba. Për riparimin e kësaj rruge me gjatësi 190 metra nga buxheti i Qytetit të Shkupit u ndanë 1,2 milion denarë.

ASFALT I RI PËR BULEVARDIN “JANE SANDANSKI”...

Bulevardi “Jane Sandanski” u shtrua me asfalt të ri nga garazhi me kate „Ilinden” deri në kryqëzimin me rrugën “Vasko Karan-gelevski”, me gjatësi 475 metra.

Gjatë punëve ndërtimore në bulevardin “Jane Sandanski” u mënjanua shtresa e asfaltit të dëmtuar ekzistues, u niveluan



PASTAJ



MË PARË

30 puseta dhe vendgrumbulime, u zëvendësuan bordurat e dëmtuara, u rinovua edhe shtresa bartëse, dhe pastaj në rrugën automobilistike u shtrua shtresë e re asfalti Split Mastiks me origjinë eruptive prej rreth 9.000 metra katrorë. Qyteti i

Shkupit për këtë punë investoi rreth 14 milion denarë.

Ky projekt është vazhdim i projektit për rikonstruksionin e bulevardit “Jane Sandanski” që Qyteti i Shkupit e realizoi në vitin 2012, kur ky bulevard u shtrua me asfalt të ri nga kryqëzimi me bulevardin “Serbia” deri në kryqëzimin tek garazhi me kate „Ilinden”.

... DHE PËR RRUGËN “KEMAL SEJFULLA”

Ekipe të Qytetit të Shkupit vjeshtën e kaluar rinovuan rrugën automobilistike edhe në rrugën “Kemal Sejfulla” në komunën Butel, e cila u rikonstruktua nga kryqëzimi me rrugën “Ferid Bajram” deri në kryqëzimin me rrugën “Bosna i Hercegovina”, me gjatësi 375 metra.

Në këtë pjesë të rrugës “Kemal Sejfulla” u mënjanua asfalti ekzistues i vjetër dhe i dëmtuar, u niveluan 22 puseta dhe vendgru-



PASTAJ



MË PARË

mbullime, u zëvendësuan bordurat e dëmtuara, u fuqizua shtresa bartëse, dhe pastaj u shtrua asfalti i ri. Qyteti i Shkupit për këtë punë investoi rreth 10 milion denarë.

Ky projekt është vazhdim i projektit për rikonstruksionin e

rrugës “Kemal Sejfulla” që Qyteti i Shkupit e realizoi në vitin 2010, kur rruga u rikonstruktua nga kryqëzimi me bulevardin “Xhon Kennedy” deri në kryqëzimin me rrugët “Vtora makedonska brigada” dhe “Ferid Bajram”. Me këtë, rruga “Kemal Sejfulla” mori një pamje krejtësisht të re.

SHATËRVANI I RI ATRAKSION NË SHESHIN „MAQEDONIA”

I rregulluar në hapësirën ndërmjet shatërvanit „Luftëtari në kalë” dhe hyrjes në Urën e gurit shatërvani i ri sipërfaqësor në sheshin „Maqedonia”, që u lëshua në gusht të vitit 2015, u shndërrua në një atraksion të vërtetë.

Bëhet fjalë për shatërvan sipërfaqësor, të ashtuquajtur të thatë me formë drejtkëndëshi me dimensione 20 x 10 metra dhe shtrat prej betonarme të groposur. Sipërfaqja mbi shtratin prej betonarme është përgatitur nga pllaka graniti të shndritshme ngjyrë gri. Në pllakat e betonit janë vendosur llamba LED me vrima për futjen e currilit. Shatërvani përbëhet nga 128 currila me 128 llamba, si dhe 16 spërkatëse të laminuara parabolike. Efekti vizual i shatërvanit arrihet me lojën e



currilave të ujit, kurse në mbrëmje me lojën e llambave.

Uji që del nga currilat depërton ndërmjet pllakave dhe kthehet përsëri në sistem.

SHESH I RI PARA KISHËS „SHËN MARIJA”

Ekipet e Qytetit të Shkupit formojnë sheshin para kishës „Shën Marija”, në hapësirën e rrugës ekzistuese „Dimitar Vlahov”, në drejtimin nga bulevardi „Filip Vtori Makedonski” deri në bulevardin „Krste Misirkov”, me sipërfaqe të përgjithshme 550 metra katrorë. Me këtë projekt, rruga „Dimitar Vlahov” do të bëhet zonë këmbësore. Në këtë hapësirë këto ditë po vendosen gurët e granitit, dhe pastaj, në sheshin e ri të formuar do të vendosen stola, koshat për mbeturina dhe dy çezma.

Në shesh do të vendoset edhe ndriçimi i ri. Që të mundësohet hyr-



ja e automjeteve të ndihmës së shpejtë, në hyrje të sheshit do të vendosen shtyllëza hidraulike metalike.

Muri i bregut, nga ana tjetër, do të vishet me mermer të bardhë, dhe pastaj në të do të montohet gardh mbrojtës me lartësi 75 centimetra.

Qyteti i Shkupit për realizimin e projektit për formimin e sheshit para kishës „Shën Marija” do të ndajë rreth 34,3 milion denarë me TVSH.

SHUTO ORIZARE DO TË KETË SISTEM TË RI UJËSJELLËSI

Ndërtimi i sistemit të ri për furnizimin me ujë të pijshëm për komunën Shuto Orizare është në vijim. Tashmë është ndërtuar karabina e pompës tek fabrika e mëparshme SHA „TIPO” në bulevardin „Slovenia” dhe po punohet në pajisjen e objektit. Në përfundim e sipër janë punët ndërtimore edhe në rezervuarin e ujit në rrugën Gvadalajara.

- Me ndërtimin e këtij sistemi të furnizimit me ujë të pijshëm do të zgjidhen problemet shumëvjeçare me furnizimin me ujë të lagjeve Shuto Orizare dhe të një pjese të lagjes Shkup veri. Për sistemin e ri të furnizimit me ujë të pijshëm do të ndërtohet rezervuar me kapacitet 4.350 metra kub në afërsi të rezervuarëve ekzistues të NP „Ujësjellës dhe kanalizim” në rrugën „Guadalajara”; stacion i ri pompimi tek fabrika e mëparshme „TIPO” në bulevardin „Slovenia” dhe tubacion me gjatësi 2,3 kilometra dhe profil 500 milimetra që do të kalojë nga stacioni i pompimit, e pastaj nëpër rrugët „Shuto Orizare”, „Vinička”, „Çe Gevara”, „Plačkovica” „Butelski venec” – thotë kryetari Koce Trajanovski.



Vlera e përgjithshme e investimit është 182.367.800 denarë me TVSH. Në financimin e këtij projekti Qyteti i Shkupit do të marrë pjesë me 43,7 për qind të mjetëve, përkatësisht me 79,7 milion denarë; NP „Ujësjellës dhe kanalizim”, gjithashtu, me 43,7 për qind, përkatësisht 79,7 milion denarë, kurse Komuna Shuto Orizare do të marrë pjesë me 12,6 për qind, përkatësisht 22,9 milion denarë të mjetëve të nevojshme financiare.

PËRMBYTJA E NËNKALIMIT NË BUTEL DO TË JETË E SHKUAR

Për të mundësuar largimin e pandërprerë të ujërave atmosferik dhe për të penguar përmbytjet në nënkalimin në Butel e kipe të Qytetit të Shkupit ndërtojnë kanalizim të ri atmosferik në rrugën „Boca Ivanova”, në drejtimin nga lumi Serava deri tek rrethrotullimi në Butel, si dhe në një pjesë të rrugës „Aleksandar Urdarevski”, nga rrethrotullimi deri tek rruga „Dushko Popoviq”.

Gjatë punëve ndërtimore për ndërtimin e kanalizimit atmosferik përgjatë rrugës „Boca Ivanova” në terren po bëhen gërmime dhe po vendosen tuba me profil 1.200 milimetra në gjatësi 782 metra. Gjatë punëve ndërtimore për ndërtimin e kanalizimit atmosferik të rrugës „Aleksandar Urdarevski”, në drejtimin nga rrethrotullimi deri tek rruga „Dushko Popoviq”, do të vendosen tuba me profil 1.000 mi-



limetra, me gjatësi 131 metra. Për këtë projekt Qyteti i Shkupit do të shpenzojë rreth 34 milion denarë.

U NDËRTUA KOLEKTORI I UJËRAVE TË ZEZA PËR INXHIOVËN

Në vendbanimin Inxhikovë është ndërtuar pjesa e tretë e kolektorit të ujërave të zeza traseja e të cilit të çon anës rrugës automobilistike „Aleksandar Makedonski” në drejtimin nga stadiumi „Boris Trajkovski”, deri tek stacioni i pompimit Maxhari. Kolektori ka gjatësi 679 metra.

- Me ndërtimin e këtij kolektori do të zgjidhet problemi me pranimin dhe largimin e ujërave të zeza nga bashkësitë vendore Tumba dhe Pitu Guli, si dhe të një pjese të vendbanimeve Çento dhe Kamnik, kurse përfitim do të kenë rreth 30.000 banorë – thotë kryetari Koce Trajanovski.

Investitor i këtij projekti është NP „Ujësjellës dhe kanalizim”, kurse vlera e investimit është rreth 12 milion denarë.

Ndërtimi i kolektorit primar të ujërave të zeza në vendbanimin Creshevë është në vijim. Kolektori ri do të jetë me gjatësi 1 400 metra, me profil të tubave 250 milimetra.

Për ndërtimin e këtij kolektori të ri për ujërat e zeza janë investuar rreth 7 milion denarë, nga të cilat 3 milion denarë do të ndajë Qyteti i Shkupit, kurse 4 milion denarë do të ndajë Komuna Gazi Baba.

MBIKALIMI PËR KËMBËSORË LIDHI HIPODROMIN DHE INXHIKOVËN

Mbikalimi për këmbësorë nëpërmjet rrugës automobilistike Shkup – Petrovec lidhi lagjet Hipodrom dhe Inxhikovë, në komunën Gazi Baba. Qyteti i Shkupit ndërtoi mbikalim çeliku me shtylla betoni, shkallë dhe rampë çeliku, që do të mundësojë kalimin e sigurt të këmbësorëve, këmbësorëve në biçikleta dhe personave me nevoja të veçanta.

Mbikalimi është me gjatësi 63 metra, dhe gjerësi 5,4 metra. Sipërfaqja për lëvizje është e gjerë 3,1 metra. Përgjatë mbikalimit është vendosur rrethim mbrojtës me lartësi 2 metra, i përgatitur me profile çeliku dhe rrjetë çeliku, si dhe konzola për instalimet. Mbikalimi i ri që lidhi lagjet Hipodrom dhe Inxhikovë ndriçohet nga 12 kandelabra, kurse ndriçohen edhe rampat.

Për ndërtimin e këtij mbikalimi Qyteti i Shkupit investoi rreth 38 milion denarë.



U NDËRTUA GARAZH MODERN ME KATE NË QENDËR

Si pjesë e përpjekjeve për zgjidhjen e problemit me parkimin në qendër, në rrugën "Dame Gruev", Qyteti i Shkupit ndërtoi garazhin modern me kate „Todor Aleksandrov”. Objekti siguron parking publik

për 604 automjete të lehta, vende parkimi për persona me nevoja të veçanta, si dhe parking për 120 biçikleta.

– Objekti ka kat përdhes, 7 kate mbi tokë dhe dy nivele nën tokë.

Në katin përdhes janë parashikuar vetëm ambiente afariste, kurse katet e tjera janë destinuar vetëm për parkim. Lëvizja e automjeteve nëpër kate zhvillohet nëpërmjet një rampe në formë spirale. Parkingu për biçikleta është rregulluar në këndin e objektit – thotë kryetari Koce Trajanovski.


Garazhi me kate „Todor Aleksandrov” është pajisur me sistemet më bashkëkohore dhe më cilësore për zbulim dhe njoftim për vende të lira parkimi; për pagimin e parkimit; video-mbikëqyrje; sistem për mbrojtjen kundër zjarrit; për zbulim dhe njoftim për SO2 dhe gaz; për mbrojtje nga shkarkimet atmosferike, si dhe sistem për aklimatizim dhe ventilim. Qyteti i Shkupit për këtë punë të rëndësishme ndau rreth 780 milion denarë.



Pronarët e elektromobilave mund të shfrytëzojnë stacionet e reja për mbushjen e automjeteve elektrike, të cilat në vitin 2015 u vendosën në garazhin me kate „Todor Aleksandrov”, në rrugën „Dame Gruev” dhe në garazhin me kate „Makedonska falanga”, në rrugën „Sveti Kiril i Metodij”.

Projekt i ri për përmirësimin e infrastrukturës së çiklizmit në qytet

SHKUPI QYTETI I BIÇIKLETAVE 2017



Qyteti i Shkupit në vitin 2015 prezantoi dhe punoi në mënyrë intensive në realizimin e projektit kapital për përmirësimin e infrastrukturës së çiklizmit në Shkup dhe për rritjen e sigurisë në komunikacionin e çiklizmit - SHKUPI QYTETI I BIÇIKLETAVE 2017.

- Qëllimi ynë është që të lehtësojmë lëvizjen e çiklistëve, tu mundësojmë të gjithë personave që përdorin biçikletë të arrijnë në destinacionin e dëshiruar dhe të formojmë rrjet efikas të korsive të biçikletave të cilat do të jenë të lidhura dhe të arritshme për përdorim – thotë kryetari Koce Trajanovski.

Me projektin SHKUPI QYTETI I BIÇIKLETAVE 2017 përgjatë rrugëve të qytetit dhe bulevardëve do të formohen katër rrugë kryesore për biçikleta, të cilat do të shtrihen në drejtimin lindje – perëndim dhe 7 rrugë lidhëse të cilat do të shtrihen në drejtimin veri – jug, si vijon: RRUGA 1 - viti 2014-2015 - Gazi Baba-Qendër-Karposh; RRUGA 2 - viti 2015-2016 – Aerodrom-Qendër-Karposh-Gjorçe Petrov; RRUGA 3 - viti 2016-2017 - Kisela Voda-Qendër-Karposh; RRUGA 4 – viti 2016-2017 - Butel-Çair-Qendër, si dhe shtatë rrugë lidhëse – viti 2017.

- Me kërkesën e çiklistëve, korsitë e


biçikletave që do të ndërtohen ose do të rinovohen do të shtrohen me asfalt; do të sigurojmë rampa për lëvizje të pandërprerë; do të mënjanojmë pengesat ekzistuese të korsive – semaforë, shenja, bilborde, kontejnerë... Korsitë e biçikletave do t'i anashkalojnë stacionet e autobusëve nga pjesa e prapme, dhe vendosëm edhe mënyrë unike të njohur për shënimin e korsive – sqaron kryetari Trajanovski.

Me realizimin e projektit SHKUPI QYTETI I BIÇIKLETAVE, deri në vitin 2017 do të ndërtohen dhe rikonstruktohen gjithsej 51 kilometër korsi për biçikleta në Shkup.

NDËRTIMI I KORSIVE TË BIÇIKLETAVE TË RRUGËS 1 – PARA PËRFUNDIMIT

Ndërtimi dhe rikonstrukcioni i korsive të biçikletave që janë pjesë e rrugës 1 të projektit të ndërlikuar SHKUPI QYTETI I BIÇIKLETAVE 2017 është në fazën përfundimtare.

Këto ditë po punohet në mënyrë intensive në korsinë ekzistuese të këmbësorëve dhe biçikletave përgjatë bulevardit "Ilinden", në drejtimin nga kryqëzimi me rrugën "Lubjanska" deri tek dyqani i luleve tek Gjendja civile, në gjatësi 2.300 metra. Asfalti i vjetër dhe i dëmtuar është gërryer, korsa është zgjeruar, janë rregulluar bordura të reja dhe është shtruar shtresë e re asfalti. Për hyrje dhe dalje nga kryqëzimi do të vendosen rampa për lëvizje të pandërprerë. Korsa do të jetë e shënuar me sinjalizim adekuat horizontal dhe vertikal.



Po rikonstruhet korsa e biçikletave në bulevardin "Ilinden"



Korsa e biçikletave në bulevardin "Aleksandar Makedonski"

"Krste Misirkov" deri tek rruga "Belasica", nga të dyja anët;

- në bulevardin "Krste Misirkov", nga Rruga e avokatëve deri në Kej, "Dimitar Vlahov";
- në bulevardin "Krste Misirkov", nga bulevardi "Goce Delçev" deri në Bit-pazar;
- në bulevardin "Kuzman Josifovski Pitu", nga Stacioni hekurudhor deri në bulevardin "Koço Racin", nga të dyja anët;
- në bulevardin Ilinden, nga kryqëzimi me bulevardin "Sveti Kliment Ohridski" deri në shatërvanin "Lotosov cvet" dhe
- në rrugën "Gjorge Petrov", nga bulevardi "Makedonska vojska" deri në urën e Sarajit.

Për të mundësuar lëvizjen e pandërprerë të çiklistëve nga Gazi Baba, nëpërmjet qendrës së qytetit deri në Karposh deri tani janë ndërtuar këto pjesë të rrugës 1 (me gjatësi të përgjithshme 8.178 metra):

- në bulevardin "Aleksandar Makedonski", nga kryqëzimi tek hoteli „Kontinental“, deri në kryqëzimin Estekada, nga të dyja anët;
- na rrugën "Belasica", nga bulevardi "Goce Delçev" deri tek kryqëzimi tek hoteli „Kontinental“, nga të dyja anët;
- në bulevardin Goce Delçev, nga bulevardi



Korsa e biçikletave në bulevardin "Goce Delçev"

QYTETI I SHKUPIT QEVERISJA E PARË VENDORE ME SKUTERË ELEKTRIKË PËR ADMINISTRATËN

Qyteti i Shkupit është qeverisja e parë vendore në Republikën e Maqedonisë e cila bleu skuterë elektrikë për nevojat e administratës së qytetit.

- Qyteti i Shkupit bleu 5 skuterë elektrikë dhe bëri hapin e parë të drejtpërdrejtë drejt elektromobilitetit në Shkup, me zbatimin e teknologjive të reja, lëvizjen me emetime zero të gazrave të dëmshme, ambient jetësor më të pastër dhe më të shëndetshëm dhe zvogëlimin e shpenzimeve për mirëmbajtje. Skuterët do t'i shfrytëzojnë shërbimet e Qytetit të Shkupit - inspektorët, ruajtësit e rendit komunal dhe të tjerë. Skuterët e blerë kanë shpejtësi maksimale 45 kilometra në orë; kohë mbushjeje 4 deri në 5 orë; me një mbushje skuteri kalon 50 kilometra, dhe, që është akoma më e rëndësishme, udhëtimi 100 kilometra me një skuter të tillë do të kushtojë 10 denarë, që përbën 70 deri në 80 për qind kursim në krahasim me shpenzimin e një skuteri që përdor derivate të naftës – thotë kryetari Koce Trajanovski.

Vlera e përgjithshme e skuterëve elektrikë është 782.458 de-



narë me TVSH. Me vënien në përdorim të skuterëve elektrikë të rinj Qyteti i Shkupit do të kursejë për karburant dhe për mirëmbajtje, dhe, që është akoma më e rëndësishme, do të kontribuojë për kualitetin e ajrit ambiental dhe për ambient jetësor më të pastër dhe më të shëndetshëm.

ELEKTROMOBILA TË RINJ PËR SHIKIM TURISTIK

Shtatë elektromobila të rinj me dizajn retro dhe pesë trotinete elektrike në fillimin e vjeshtës së kaluar u vunë në dispozicion të qytetarëve për shikimin turistik të monumenteve në qendrën e qytetit.

Automjetet huazohen në punktin e NP „Parkingu i qytetit” në sheshin „Maqedonia”. Bileta e udhëtimit me elektromobil kushton 50 denarë, kurse çmimi i huazimit të trotineteve elektrike është 100 denarë në orë.

Për blerjen e elektromobilave NP „Parkingu i qytetit” investoi rreth 6 milion denarë, pa TVSH, kurse për blerjen e 5-së trotineteve elektrike rreth 1,9 milion denarë, pa TVSH.



U vendos sistem i ri për pagimin e biletave në transportin publik **ZËVENDËSONI BILETAT E LETRËS DHE KARTAT E LIRA ME KARTA ELEKTRONIKE**



Qyteti i Shkupit në vitin 2015 filloi me vendosjen e sistemit të ri për lokacionin automatik të automjeteve në autobusët e transportit publik. Deri tani, kjo mënyrë e re e pagimit të biletave funksionon si provë, kurse qytetarët tashmë filluan t'i zëvendësojnë biletat e vjetra prej letre me kartat e reja elektronike. Gjatë vitit 2016 biletat e vjetra prej letre, kartat e lira dhe pagimi kesh do të nxirren nga përdorimi, kurse në autobusët e transportit publik urban (edhe në autobusët e NQP-së edhe tek transportuesit urbanë) do të bëhet i mundur përdorimi i kartave të reja elektronike.

Më shumë informacione për sistemin elektronik të pagimit dhe mënyrën e funksionimit të kartave të reja qytetarët mund të marrin në portalin www.skopska.mk, si dhe në linjën telefonike falas 0 800 15 115.

Paralelisht me sistemin për pagimin elektronik, në automjetet e transportit publik zbatohet edhe sistemi për lokacionin automatik të automjeteve, me të cilin ndiqet lëvizja e çdo autobusi, nga stacioni i fillimit deri në stacionin e fundit. Në stacionet e autobusit do të vendosen mbi 50 ekrane informuese nëpërmjet të cilave qytetarët do të informohen për kohën e arritjes së autobusëve, dhe do të jenë të arritshme edhe mjete të tjera komunikimi për informim.

Sistemi për lokacionin automatik të automjeteve dhe për pagimin elektronik duhet të instalohet në 500 autobusë të transportit urban. Ky sistem deri tani është instaluar në 385 autobusë të NQP-së, dhe do të instalohet edhe në 115 autobusë të transportuesve privatë.

Projekti për vendosjen e sistemit të ri për lokacionin automatik të automjeteve dhe për pagimin elektronik është financuar plotësisht nga Qyteti i Shkupit dhe kushton afërsisht 3 milion euro.



Cikli i 12-të dhe 13-të i vizitave në komunat e Shkupit

TAKIME ME QYTETARËT PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMEVE URBANE

Gjatë vitit 2015 përfaqësuesit e bashkësive urbane dhe vendore të 10 komunave të Shkupit kishin mundësi të takohen me kryetarin e Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, me drejtorët e ndërmarrjeve publike dhe me përfaqësuesit e administratës së qytetit në suazat e ciklit të 12-të dhe 13-të të vizitave në komunat e Shkupit.

Në këto takime përfaqësuesit e bashkësive urbane dhe vendore kishin mundësi të transmetojnë qëndrimet dhe mendimet e tyre për punën e ndërmarrjeve publike dhe administratës së qytetit, të japin propozime për tejkalimin e gjendjeve dhe problemeve të caktuara, të bisedojnë për projektet më të rëndësishme që janë parashikuar për vitin 2016.

Si pjesë e ciklit të takimeve në komunat e Shkupit u organizuan aksione të mëdha për pastrimin e sipërfaqeve publike.



SHKOLLAT E MESME „ARSENI JOVKOV” DHE „ZEF LUSH MARKU” NGROHEN ME GAZ

Shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit „Arseni Jovkov” dhe „Zef Lush Marku” nga ky sezon i ngrohjes filluan të ngrohen me gaz.

- Në fillim të sezonit të ngrohjes lëshuam në përdorim kaldajat me gaz në SHMQSH „Arseni Jovkov”, ku mësojnë rreth 2.000 nxënës dhe në SHMQSH „Zef Lush Marku” ku mësojnë rreth 2.200 nxënës. Projekti për gazifikimin e këtyre dy shkollave është me vlerë 15 milion denarë. Sipas llogaritjeve, pritet të kursehen rreth 50 për qind e mjeteve financiare të cilat shpenzoheshin më parë për ngrohje dhe kthim i investimit për rreth katër vjet. Deri tani, gazifikimi është realizuar në dy shkolla të mesme të Qytetit të Shkupit, përkatësisht në SHMQSH „Zdravko Cvetkovski” dhe në SHMQSH „Georgi Dimitrov”. Janë përgatitur projekte për gazifikimin e shtatë shkollave të mesme. Në periudhën që vjen do të punojmë në gazifikimin e SHMQSH „Dr. Pançe Karagjov”, dhe pastaj edhe në shkollat e tjera të mesme për të cilat janë përgatitur projekte – sqaroi kryetari Koce Trajanovski.

Me realizimin e këtij projekti Qyteti i Shkupit kontribuon për një ambient jetësor më të pastër dhe më të shëndetshëm dhe për kualitet më të mirë ajrit ambiantal në qytet.



Në shkollën e mesme „Arseni Jovkov”



Në shkollën e mesme „Zef Lush Marku”

TAKIMI NDËRMJET TË PARIT DHE MË TË MIRËVE

Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski 25 maturantëve më të mirë – nxënësve të shkëlqyer të gjeneratës 2011/2015 nga 21 shkollat e mesme nga Shkupi u ndau mirënjohje dhe shpërblime në të holla, si pjesë e manifestimit „Takimi ndërmjet të parit dhe më të mirëve”, që u mbajt më 18 qershor 2015 në Teatrin popullor të Maqedonisë.

U SHPËRBLYEN NXËNËSIT MË TË MIRË

Më 26 qershor 2015 kryetari Koce Trajanovski, në ambientet e Qendrës kulturore informative, u ndau mirënjohje dhe shpërblime nxënësve që u klasifikuan më mirë në garat regjionale të Shkupit në 12 lëndë mësimore.

Qyteti i Shkupit në vitin 2015 për herë të parë realizoi projektin për përkrahjen e garave në shumë lëndë mësimore që realizohen nga shoqata të akredituara për organizimin e garave në shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit. Për 55 nxënësit e klasifikuar më mirë në garat regjionale të Shkupit u ndanë edhe shpërblime në të holla me vlerë nga 4.000 denarë.

Në vitin 2015 janë investuar 31,3 milion denarë për rikonstrukcionin e objekteve shkollore

NUK KA MË ÇATI AZBESTI NË SHKOLLAT E MESME

PASTAJ



SHMQSH "Pançe Arsovski"

nën kompetencat e tij, që paraprakisht ishin të shtruar me pllaka azbesti.

- Gjatë verës së vitit 2015 u kryen punë ndërtimore në dhjetë shkolla të mesme, dhe Qyteti i Shkupit për realizimin e këtij projekti nga buxheti ndau rreth 31,3 milion denarë. Në SHMQSH „Rade Jovčevski-Korçagin” u zëvendësuan dritaret; në SHMQSH „Cvetan Dimov” u zëvendësua zdrukthëtaria dhe u rinovuan dyshemetë e objektit shkollor; SHMQSH „Pançe Arsovski” u bë me fasadë dhe çati të re; në SHMQSH „Orce Nikolov” u punua në rikonstrukcionin e dritareve; në SHMQSH „Nikolla Karev” u riparua çatia; në SHMQSH „Vlado Tasevski” u rikonstruktuan nyjat sanitare; në SHMQSH „Vëllezërit Miladinov” dhe SHMQSH „Arseni Jovkov” u rikonstruktua sipërfaqja e oborrit të shkollës; kurse në SHMQSH „Zdravko Cvetkovski” u zëvendësua çatia e vjetër prej azbesti e objektit shkollor dhe nyjat sanitare në sallën e sportit. Me këtë, kontribuam në mënyrë të ndjeshme në përmirësimin e kushteve për punë të nxënësve dhe kuadrit mësimdhënës – tha kryetari Koce Trajanovski.

MË PARË



Për përmirësimin e kushteve në të cilat mësojnë nxënësit e shkollave të mesme, Qyteti i Shkupit gjatë pushimeve verore vitin e kaluar rinovoi dhe

rikonstruktui objektet në nëntë shkolla të mesme që janë nën kompetencat e tij. Ndërmjet të tjerash, u zëvendësua edhe çatia e vjetër prej azbesti në objektin shkollor dhe në sallën e jashtme të fizikulturës në SHMQSH „Zdravko Cvetkovski”. Me këtë, Qyteti i Shkupit mënjanoi çatitë e vjetra të dëmshme prej azbesti nga të gjitha shkollat e mesme



U zëvendësua çatia e vjetër në SHMQSH "Zdravko Cvetkovski"

NË SHUTO ORIZARE U NDËRTUA SHKOLLË E MESME

SHMQSH „Saip Jusuf” është emri i shkollës së mesme që u hap në fillimin e vitit shkollor në komunën Shuto Orizare, dhe u bë kështu shkolla e mesme e 22-të nën kompetencat e Qytetit të Shkupit. Shkolla e re e mesme është me sipërfaqe të përgjithshme 4.405 metra katrorë, dhe ka 12 klasa, 4 kabine, sallë të madhe fizikulture, sallë leximi dhe bibliotekë.

- Shkolla e re e mesme në Komunën Shuto Orizare do të mundësojë proces arsimor me cilësi për nxënësit e kësaj komune. Qyteti Shkupit në buxhetin e tij ka parashikuar mjete për pajisjen e shkollës në të cilën nxënësit mund të ndjekin mësimin në degën e ekonomisë, parukerisë dhe ndërtimit – thotë kryetari Koce Trajanovski.



U RREGULLUA PJESA E DYTË E PARKUT “MAQEDONIA”

Pjesa e dytë e parkut „Maqedonia”, që shtrihet përgjatë bulevardit “Mitropolit Teodosij Gologanov”, në qershor të vitit 2015 mori një pamje të re dhe të rregulluar.

- Ky park me sipërfaqe të gjelbër rreth 32.000 metra katrorë, paraprakisht ishte lënë pas dore dhe në të kishte plepa të vjetër që përbënin rrezik për kalimtarët dhe pushuesit. Në park tani është formuar një korsi rekreacioni me zhavorr të bardhë dhe një korsi e asfaltuar me 48 stola për ndenje, kosha për mbeturina dhe pajisje të tjera urbane. Janë vendosur



MË PARË



edhe 3 vend-panorama, kurse në njërin prej tyre janë vendosur 4 tabe-la mermeri shahu. Në park ka përmbytje të destinuara për fëmijët, si dhe elemente fitnes për ushtrim. Në pjesën e dytë të Parkut „Maqedonia” është vendosur rrjet i ri hidranti me 192 spërkatëse me të cilat do të ujitet gjelbërimi. Për rregullimin e pjesës së dytë të Parkut „Maqedonia” nga Buxheti i Qytetit të Shkupit janë ndarë rreth 15 milion denarë. Në park është vendosur edhe ndriçim i ri gjë për të cilin Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth një milion denarë. Në aksionin e vjeshtës për mbjellje në këtë park mbollëm mbi 300 drurë gjetherënës, që parku të marrë pamjen e vërtetë – sqaroi kryetari Koce Trajanovski.

PARKU NË BULEVARDIN “FEVRUARSKI POHOD” SË SHPEJTI ME PAMJE TË RE

Rregullimi i parkut të ri tek bulevardi “Fevruarski pohod”, në lagjen Aerodrom, është në fazën përfundimtare. Tashmë janë formuar edhe korsitë e rekreacionit të tampo-nuara, po vendoset sistemi për ujitje, dhe është gjelbëruar edhe pjesa më e madhe e parkut.

Parku i ri në lagjen Aerodrom është me sipërfaqe prej rreth 82.000 metra katrorë dhe do të jetë më i madh se pjesa e parë e Parkut të qytetit. Në të do të vendosen stola për ndenje, kosha për mbeturina dhe pajisje të tjera urbane, dhe do të rregullohen edhe terrene sportive. Përgjatë parkut do të vendosen vend-panorama.

Për realizimin e këtij projekti Qyteti i Shkupit do të ndajë rreth 16 milion denarë.



PËRMBAJTJE TË REJA NË PARKUN E NATYRËS „GAZI BABA”



Ekipet e Qytetit të Shkupit dhe të NP „Rrugë dhe rrugica” në gusht të vitit 2015 ndërtuan dy korsi rrugore në Parkun e natyrës „Gazi Baba” dhe rregulluan ambientin me vend-panorama, pajisje urbane dhe përmbajtje zbavitëse.

- Ekipet e NP „Rrugë dhe rrugica” ndërtuan një korsi të re këmbësorësh në parkun e natyrës „Gazi Baba” e cila shtrihet nga Fakulteti i shkencave natyrore drejt lagjes Hekurana, nga ana e Çairit. Korsia është me gjatësi 1.200 metra, dhe gjerësi nga 2,6 deri në 3 metra, në varësi të kushteve të terrenit. Është shtruar me zhavorr të bardhë, kurse përgjatë saj janë vendosur tre korsi rrugore me elemente fitnes, elemente rekreative për fëmijë, 15 komplete druri me tavolina, çezma për ujë dhe 4 vend-panorama. Në mënyrë plotësuese, është rregulluar edhe një korsi rekreacioni me gjatësi rreth 400 metra dhe gjerësi 3 metra, e cila të çon nga Fakulteti i shkencave natyrore deri tek kopshti i mëparshëm në Gazi Baba. Kjo korsi është shtruar me asfalt dhe ndriçohet nga 31 shtylla për ndriçim. Janë vendosur edhe 4 shtylla në të cilat janë montuar 4 reflektorë për ndriçimin e terrenit të futbollit dhe 2 reflektorë për ndriçimin e terrenit të basketbollit. Ekipet e NP „Parqe dhe gjelbërime”, nga ana tjetër, punuan në rregullimin e gjelbërimit dhe vendosjen e elementeve rekreative. Rregullimi i Parkut të natyrës „Gazi Baba” mundësoi kushte më të këndshme të qëndrimit në natyrë për qytetarët dhe ofroi përmbajtje të reja për pushim dhe çlodhje. Në këtë projekt për rregullimin e Parkut të natyrës „Gazi Baba” Qyteti i Shkupit ka investuar rreth 6,6 milion denarë – thotë kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski.

Në Vodno

U RINOVUA KORSIA E ALPINIZMIT „SLOVENSKA”

Adhuresit e natyrës dhe sporteve alpinistike mund të ushtrojnë në korsinë e këmbësorëve-alpinizmit të rinovuar „Slovenska”, e cila në qershor të vitit 2015 mori një pamje të re nga stacioni i policisë „Vodno” deri në Vodnon e Mesme. Korsinë e rinovoi Qyteti i Shkupit në bashkëpunim me Federatën e sporteve të alpinizmit dhe NP „Parqe dhe gjelbërime”.

Korsia e rinovuar është me gjatësi të përgjithshme 2.100 metra. Gjatë rikonstruksionit, në korsi u vendosën 34 shkallë të reja druri, dhe janë rinovuar edhe 30 shkallë ekzistuese. Për shkak të lëvizjes së sigurt, në tre vende është vendosur gardh mbrojtës. Janë montuar edhe shtatë tabela udhërrëfyese dhe katër tabela informuese.



NË SIPËRFAQET E GJELBRA U MBOLLËN MBI 9.500 FIDANË



- Qyteti i Shkupit organizon aksione të vazhdueshme për mbjelljen e drurëve të rinj në sipërfaqet publike, ngremë sipërfaqe të reja gjelbërimi dhe rregullojmë kate pushimi dhe rekreacioni në natyrë. Me këtë kontribuojmë për ambient jetësor më të pastër dhe për ruajtjen e shëndetit të njerëzve – thotë kryetari Koce Trajanovski.

Gjatë vitit 2015 në sipërfaqet e gjelbra ekupe të Qytetit të Shkupit mbollën mbi 9.500 fidanë dhe rreth një milion lule sezonale. Fidanët e rinj u mbollën përgjatë bulevardëve, në parqe dhe në një pjesë të gjelbërimit të blloqeve.

Vetëm për aksionin e vjeshtës, u mbollën rreth 5.500 drurë gjetherënës, të

cilët pasuruan gjelbërimit përgjatë rrugëve, parqeve, gjelbërimit e blloqeve dhe oborreve të të gjitha shkollave të mesme nën kompetencat e Qytetit të Shkupit.

Në mënyrë plotësuese, bashkësive të interesuara urbane dhe vendore dhe këshillave banesorë iu ndanë rreth 4.000 fidanë, në dy aksione, atë pranveror dhe të vjeshtës.



Në oborrin e SHMQSH "Vëllezërit Miladinov"



FESTIVALI I DYTË I LULEVE I SHKUPIT



Festivali i dytë i luleve i Shkupit, që u mbajt nga data 16 deri më 17 maj 2015 në pjesën e dytë të Parkut të qytetit, tërhoqi mijëra vizitorë të cilët kishin mundësi t'i shikojnë lulet e ekspozuara, të kënaqen me aranzhimet e luleve, të edukohen dhe zbavitën në ambient të hapur.

Festivali i luleve, që u mbajt nën kujdestarinë e Qytetit të Shkupit, dhe nën organizimin e NP „Parqe dhe gjelbërim“, u mundësoi vizitorëve të shikojnë ofertën e pasur të luleve dhe fidanëve të ndryshëm, të marrin pjesë në punëtoritë kreative, ku të punësuar nga NP „Parqe dhe gjelbërim“ ndanë eksperiencat për mbjelljen e drejtë dhe kultivimin e luleve, dhe të kalojnë momente të këndshme në natyrë me familjet e tyre ose me miqtë.

U NDËRTUA VENDBANIM I RI PËR FOKAT

Në Kopshtin zoologjik është ndërtuar vendbanim për fokat dhe flamengon e vogël. Pishina është me kapacitet 450 metra kub, kurse për mirëmbajtjen e kualitetit të ujit është vendosur rreth qarkullues nëpër pusët, stacion pompimi për ujin e papastër, stacion pastrimi për ujërat e zeza, rezervuar për ujin e pastër, filtër pastrues automatik, pompë qarkulluese, sterilizues UV për dezinfektimin e ujit, etj.

Ky projekt është financuar nga IP „Kopshti zoologjik Shkup“, si dhe nga donacione nga Lotaria kombëtare e Maqedonisë dhe nga Agjencia për komunikime elektronike. Investimi është me vlerë rreth 6.4 milion denarë.

Në Kopshtin zoologjik është hapur edhe qendër edukative shumë funksionale që do të shfrytëzohet edhe si sallë për lojëra, sallë për seminare dhe takime, qendër informative,... Ndërtimi i qendrës është financuar nga IP „Kopshti zoologjik Shkup“, i cili për realizimin e këtij projekti ka ndarë rreth 5,7 milion denarë.



U PASURUAN ME PESHQ UJËRAT E VARDARIT

Nën organizimin e Qytetit të Shkupit, GEF (Fondi global për mbrojtjen e ambientit jetësor), Institutit për blegtori-Seksioni për peshkim dhe Federatës maqedonase të peshkimit më 18 qershor në ujërat e lumit Vardar, tek hoteli „Aleksandar Palas“, u lëshuan 5.000 copë troftë endemike maqedonase (Salmo macedonicus, Karaman, 1924).

KONTEJNERËT NËNTOKËSORË – ZGJIDHJE PËR MBETJET E AMVISËRIVE

Kontejnerët nëntokësorë që në fillimin e vitit 2015 u vendosën në shumë lokacione në komunat Kisela Voda, Gazi Baba dhe Aerodrom janë në funksion dhe mundësojnë seleksionimin më efikas të mbetjeve nga amvisëritë.

Në komunën Kisela Voda kontejnerë nëntokësorë u vendosën në tre lokacione, në Draçevë, në rrugën "Dimitrie Çupovski"; tek SHF „Krume Kepeski” dhe në rrugën "Mihail Cakov", tek SHF „Nevena Georgieva Dunja”. Për realizimin e këtij projekti janë ndarë gjithsej 6,6 milion denarë, përkatesisht, me nga 2,2 milion denarë, marrin pjesë Qyteti i Shkupit, Komuna Kisela Voda dhe NP „Higjiena komunale”.



Në komunën Gazi Baba kontejnerë nëntokësorë janë vendosur edhe në lagjen Hekurana, në rrugën "Gemixhiska"; në lagjen Çento (stacioni i fundit i autobusit numër 45, tek pallatet) dhe në lagjen Autokomandë (tek Shtëpia e pensionistëve). Në çdo lokacion janë vendosur nga tre kontejnerë nëntokësorë. Për këtë projekt janë ndarë 6,6 milion denarë, përkatesisht, me nga 2,2 milion denarë, marrin pjesë Qyteti i Shkupit, Komuna Gazi Baba dhe NP „Higjiena komunale”.

Në komunën Aerodrom kontejnerë nëntokësorë janë vendosur – në bulevardin "Fevruarski pohod"; në bulevardin "Jane Sandanski", tek QT „Tri biseri” dhe në bulevardin "Jane Sandanski", tek QT „Kapitol”. Në çdo lokacion janë vendosur nga tre kontejnerë nëntokësorë, nga të cilët dy janë për mbetje të përziera nga amvisëritë, dhe një kontejner për ambalazh PVC. Investimi i përgjithshëm për këtë projekt është 6,6 milion denarë dhe në mënyrë të barabartë, me nga 2,2 milion denarë, marrin pjesë Qyteti i Shkupit, Komuna Aerodrom dhe NP „Higjiena komunale”.



MËNYRË E RE E GRUMBULLIMIT TË MBETJEVE GABARITE

Qyteti i Shkupit më 6 dhjetor promovoi 5 automjete të reja të NP „Higjiena komunale” për grumbullimin e mbetjeve gabarite dhe inerte.

- Fillojmë me një mënyrë të re të grumbullimit të mbetjeve gabarite dhe inerte. Ky aksion është ndërmarrë me kërkesë të qytetarëve. Me vendosjen e programit të ri për trajtimin e këtyre mbetjeve, qytetarët do të kenë mundësi të merren vesh me komunën në të cilën jetojnë dhe me NP „Higjiena komunale” që 4 herë në vit falas, në vende dhe në orare të caktuara, t'i lënë sendet e vjetra dhe të panevojshme dhe ato inerte nga rinovimet, të paketuara dhe të vendosura nëpër thasë. Qytetarët gjatë vitit në çdo kohë mund t'i thërrasin ekipet e NP „Higjiena komunale” të ngrenë këtë lloj mbetjeje para shtëpive të tyre, por me një pagim simbolik për shërbimin e dhënë. Gjithashtu, theksojmë se vetë qytetarët mundën vetë falas, në çdo kohë dhe me transportin e tyre këtë lloj mbetjeje ta hedhin në oborrin e riciklimit të NP „Higjiena komunale” në Karposh. Me blerjen e këtyre 5 automjeteve të reja të specializuara në vlerë prej 8

milion denarë shpresojmë dhe presim përmirësimin e trajtimit të këtyre mbetjeve – thotë kryetari Koce Trajanovski.

Qytetarët mund të lajmërohen në telefonin falas 0 800 222 33 dhe të thërrasin shërbimin për të grumbulluar mbetjet.



U BLENË 1.000 KONTEJNERË PLASTIKË PËR MBETJE

Ndërmarrja publike „Higjiena komunale” në vitin 2015 bleu 1.000 kontejnerë të rinj plastikë për mbetje komunale të cilët u vendosën nëpër rrugët e qytetit.

Me qëllim që të përmirësohet ngritja e mbetjeve nga territori i qytetit të Shkupit, u blenë 1.000 kontejnerë të rinj plastikë, secili me kapacitet 1,1 metër kub. Këto kontejnerë plotësojnë standardet EN 840-2,5,6 dhe janë përgatitur nga polietilen i paricikluar me molekularitet të lartë, rezistues ndaj temperaturave të larta dhe të ulëta, rrezeve UV dhe ndikimeve kimike dhe biologjike. Apelojmë deri tek qytetarët që në këto kontejnerë të mos hedhin mbetje të djegshme dhe t'i ruajnë nga dëmtimet – deklaroi kryetari Koce Trajanovski, në promocionin e kontejnerëve të rinj, që u mbajt më 5 maj.

Kontejnerët e blerë janë me kapak të sheshtë i cili hapet me



mekanizëm që vihet në lëvizje me këmbë, dhe zbrazen në automjetet ekzistuese të NP „Higjiena komunale”.

Donacion nga Pakomak

80 KONTEJNERË TË RINJ PËR SELEKSIONIMIN E MBETJEVE



Në muajin nëntor Qyteti i Shkupit mori donacion nga SHPK „Pakomak” – Shkup, 80 kontejnerë plastikë.

- Këto kontejnerë plastikë janë në formë zileje, me vrimë për

hedhjen e mbetjeve. Kontejnerët janë me kapacitet 1,5 metra kub dhe në tre ngjyra, në varësi të llojit të mbetjeve që do të hidhen në to. Me realizimin e këtij projekti do të përmirësohet në mënyrë ndjeshme higjiena në Shkup, dhe për herë të parë në Republikën e Maqedonisë do të fillojmë të mbledhim mbetje të seleksionuara qelqi – thotë kryetari Koce Trajanovski.

Drejtori i NP „Higjiena komunale”, Rakip Doçi, sqaron se në periudhën e ardhshme kontejnerët e rinj do të vendosen në shumë lokacione nëpër rrugët e qytetit.

Ndërmarrja publike e priti e përgatitur donacionin – blemë dhe adaptuam automjet special për mbledhjen e mbetjeve nga këto kontejnerë. Automjeti është me kapacitet 8 ton dhe vinç special i cili mund të ngrejë kontejnerin me peshë deri në 5 ton – tha Doçi.

Për blerjen e automjetit të ri me vinç special NP „Higjiena komunale” shpenzoi rreth 6 milion denarë.

PASTROHEN RREGULLISHT SHTRËTËRIT E LUMENJVE VARDAR DHE SERAVA

Qyteti i Shkupit në vitin 2015 organizoi aktivitete të rregullta për pastrimin e shtrëtrëve dhe pjerrësive të lumenjve Vardar dhe Serava, si dhe të kanalit Usjanski, ku u mënjanuan mbetje dheu, lym, mbetje komunale dhe vegjetacion i ulët.

Në terren punuan ekipet e NP „Rrugë dhe rrugica”.



SHPËRBLIME PËR KONTRIBUTIN MË TË MADH NË MBROJTJEN E AMBIENTIT JETËSOR



Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski më 5 qershor – Dita e ambientit jetësor, ndau shpërblimet për më të mirët në konkursin tradicional të qytetit për kontributin më të madh në fushën e mbrojtjes së ambientit jetësor, për oborrin e rregulluar më mirë dhe për hartimin dhe vizatimin më të mirë me temë nga ekologjia për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme.

Për kontributin më të madh në fushën e mbrojtjes së ambientit jetësor shpërblimin e mori Kompania „F-GRUPACIJA” – kompani e licencuar për kryerjen e veprimtarisë për deponimin dhe trajtimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike dhe lloje të tjera mbetjesh, mbetje nga bateritë dhe akumulatorët, mbetje plastike, letër etj., e cila në tre vitet e fundit ka deponuar dhe trajtuar rreth 200 ton mbetje nga pajisjet elektrike dhe elektronike, rreth 10 ton bateri dhe rreth 50 ton akumulatorë.

Për oborrin e rregulluar më mirë në shtëpi individuale, shpërblimin e ndanë:

- Stojan Arsiq, për oborrin në lagjen Keramidnica
- Igor Cvetkovski, për oborrin në lagjen Draçevë

Për hartimin më të mirë me temë nga ekologjia, për nxënësit të shkollave fillore shpërblimi shkoi në duart e:

- Jovana Nedelkovska klasa e VII-të SHF „Naum Ohridski”

Për hartimin më të mirë me temë nga ekologjia, për nxënësit të shkollave të mesme shpërblimi shkoi në duart e:

- Anja Petkovska klasa II-b në SHMQSH „Koço Racin”

Për vizatimin më të mirë me temë nga ekologjia, për nxënësit të shkollave fillore shpërblimin e ndanë:

- Angela Ackovska klasa V-a në SHF „Vojdan Çernodrinski” dhe
- Nadica Angelovska klasa VII-b në SHF „Grigor Prliçev”

Për vizatimin më të mirë me temë nga ekologjia, për nxënësit të shkollave të mesme shpërblimi shkoi në duart e:

- Stefan Aleksandarski klasa II-a në SHMSHAP „Lazar Liçenoski”.



DITË TË PRANVERËS – DITË TË EKOLOGJISË

Si pjesë e manifestimit tradicional të qytetit „Ditë të pranverës – Ditë të ekologjisë” më 20 mars 2015 në parkun e natyrës „Gazi Baba” u mbajt ligjërata edukative për mbrojtjen e bufit dhe aksione për mbjelljen e drurëve.

Ligjëratat edukative për rëndësinë dhe mbrojtjen e bufit, për fëmijët e kopshtit „Detska radost” në komunën Gazi Baba, i realizoi

Shoqata maqedonase për mbrojtjen e bufit („Macedonia owl trust”), kurse në park u vendosën shumë shtëpiza për bufët. Nxënësit të SHMQSH „Pançe Arsovski” dhe të SHMQSH „Cvetan Dimov”, nga ana tjetër, mbollën rreth 100 drurë.

Aksion për mbjelljen drurëve u mbajt edhe në Vodnon e Mesme, tek stacioni i parë i teleferikut, ku Qyteti i Shkupit në bashkëpunim me Shoqatën për menaxhimin me paketimet dhe mbetjet „PAKOMAK” mbollën 60 drurë, dhe u vendosën tabela me mesazhe ekologjike dhe me të dhëna historike për Shkupin përgjatë korsive alpinistike të park pyllit „Vodno”.

AKSION PËR PASTRIM NË DITËN E PLANETIT TOKË

Qyteti i Shkupit, Komuna Gazi Baba dhe Fakulteti i shkencave bujqësore dhe ushqimit më 22 prill vitit 2015 organizuan aksion të madh për pastrimin dhe rregullimin e korsive të këmbësorëve dhe sipërfaqeve të gjelbra përgjatë bulevardit „Aleksandar Makedonski”, nga kryqëzimi me rrugën „16. Makedonska brigada” deri në kryqëzimin me nivele tek hoteli „Kontinental”, si dhe në oborrin e kompleksit të fakultetit. Aksioni për pastrim u organizua me rastin e 22 prillit – Dita e planetit Tokë, si pjesë e projektit „Ndërtojme të ardhme të shëndetshme, të gjelbër dhe të sigurt”.



Si një nga masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit

RRUGËT AUTOMOBILISTIKE TË QYTETIT TRAJTOHEN ME KALCIUM MAGNEZ ACETAT

Qyteti i Shkupit nëpërmjet NP „Higjiena komunale” vjeshtën e kaluar për herë të parë filloi t'i spërkasë rrugët automobilistike të qytetit me kalcium magnez acetat, si një nga masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit ambiental. Me këtë proces janë përfshirë disa rrugë automobilistike të qytetit - bulevardi “Sveti Kliment Ohridski” dhe rrugët “Sveti Kiril i Metodij” dhe “Jordan Mijalkov”, në qendrën e qytetit, si dhe bulevardet “Treta makedonska brigada” dhe “Serbia”, në Aerodrom. Për realizimin e këtij procesi, NP „Higjiena komunale” adaptoi 6 automjete.

Bëhet fjalë për një lëndë që përdoret për kontrollin dhe zvogëlimin e pluhurit të imët (grimcat PM10 dhe PM2,5) dhe për stabilizimin e rrugëve. Lënda që përdoret është prodhim ekologjik, i tretshëm, nuk është i dëmshëm për bimësinë (është i volitshëm për aplikacion në afërsi të parqeve dhe sipërfaqeve të gjelbra), dhe më e rëndësishme është se nuk është korrozive (nuk do të shkaktojë dëmtime të automjeteve). Prodhimi është i lehtë për aplikim dhe është tërësisht i qëndrueshëm, që do të thotë se mund të ruhet për një periudhë të gjatë kohore. Gjatë aplikimit të tij si rezultat i përbërjes mund të ndjehet një erë e lehtë uthulle, që gjithashtu nuk është e rrezikshme për shëndetin e njerëzve.

Shpejtësia në rrugët automobilistike ku aplikohet përzjerja kalcium magnez acetat kufizohet në 40 kilometra/orë, për shkak të mundësisë së rrëshqitjes së rrugës. Në rrugë janë vendosur edhe sinjalizime adekuate rrugore.



JAVA EUROPIANE E MOBILITETIT 2015



Me prezantimin e aktiviteteve që ndërmerren për mbrojtjen e ambientit jetësor dhe natyrës Qyteti i Shkupit më 16 shtator shënoi fillimin e manifestimit „Java europiane e mobilitetit 2015”. Anëtarësimin për përfshirje në javën që i përkushtohet promovimit të llojeve alternative të transportit dhe mbrojtjes së ambientit jetësor e nënshkroi kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski.

Gjatë javës së mobilitetit 2015 u mbajtën ligjërata të shumta për llojet alternative të transportit, prezantime të projektit „SHKUPI QYTETI I BIÇIKLETAVE 2017”, aksione për pastrimin e Vodnos, trajnime për automjete elektrike, biçikleta elektrike dhe mopedë elektrike për nxënës të shkollave fillore të Shkupit, ekspozitë e automjeteve elektrike dhe hibride, si dhe punëtori për sfidat me të cilat përballohen ambientet urbane si rezultat i ndryshimeve klimaterike, me zbatimin e metodologjisë Forsajt.

Java europiane tradicionale e mobilitetit përfundoi me defileun e madh të biçikletave që u mbajt në rrugët e qytetit më 22 Shtator – Dita ndërkombëtare pa automobila.

GARA REPUBLIKANE SPORTIVE TË PENSIONISTËVE

Katërqind pensionistë morën pjesë në garat republikane të pensionistëve që më 4 shtator 2015 u mbajtën në kompleksin „Nju star”. Pensionistët garuan në shumë disiplina sportive siç janë, tërheqje litari, tabell, shah, pikado, qitje dhe vrapim.

– Qyteti i Shkupit ka një bashkëpunim të shkëlqyer me Lidhjen e pensionistëve të Qytetit të Shkupit, i cili bazohet në marrëveshjen e ndërsjellët dhe pjesëmarrjen e përbashkët në realizimin e programeve dhe aktiviteteve të ndryshme që kanë për qëllim realizimin e një jete më me cilësi për pensionistët. Bashkëpunimi do të vazhdojë edhe më tej. Qyteti organizon transport në grup për pensionistët në vende ekskursioni në territorin e Shkupit dhe territorin e Republikës së Maqedonisë, si dhe transport falas për persona të moshuar katër ditë në javë – të martën, të premten, të shtunën dhe të dielën. Qyteti i Shkupit çdo vit nga buxheti i vetë ndan 500 000 denarë për



përkrahjen e aktiviteteve të Lidhjes së pensionistëve të Qytetit të Shkupit – theksoi kryetari Koce Trajanovski, në ndarjen e çmimeve për pjesëmarrësit më të suksesshëm në këto lojëra.

KONCERT I KËNGËVE DHE VALLEVE TË PENSIONISTËVE 2015



Koncerti republikan i pensionistëve i këngëve, muzikës dhe valleve 2015 u mbajt më 9 qershor, në Operën dhe baletin maqedonas.

– Ky koncert i cili bashkon aktivitetet e mbi 40 shoqatave në vendin tonë është me rëndësi të jashtëzakonshme për pensionistët në Maqedoni, dhe kjo jo vetëm për shkak të kontributit që ka në ruajtjen e traditës kulturore, nëpërmjet folklorit, por është i rëndësishëm edhe, sepse jep mundësi për shoqërim, socializim dhe jetë më të gjatë dhe më me kualitet të pensionistëve. Pikërisht për këtë edhe Ministria e kulturës e shpalli këtë manifestim si interes kombëtar për kulturën e shtetit – theksoi kryetari Koce Trajanovski, në fjalën e tij para të pranishmëve në Koncertin republikan të pensionistëve të këngëve, muzikës dhe valleve 2015.

U HAP QENDRA DITORE PËR PERSONA ME PENGESA INTELEKTUALE

Në rrugën „Vasil Gjorgov” numër 4, në Kapishtec, më 10 qershor 2015 u hap Qendra e re për persona me pengesa intelektuale mbi moshën 18 vjeç.

Hapja e Qendrës ditore është rezultat i iniciativës së përbashkët të Qytetit të Shkupit, Ministrisë për punë dhe politikë sociale dhe Qendrës republikane për përkrahjen e personave me pengesa intelektuale „PORAKA” nga Shkupi. Qendra ditore siguron rregullimin dhe qëndrimin, kurimin, ushqimin, rehabilitimin psikologjik, social dhe riedukimin, punë adekuate dhe kalimin e kohës në mënyrë të organizuar të personave me pengesa në zhvillimin intelektual, mbi moshën 18 vjeç.

Për funksionimin e Qendrës ditore në Kapishtec, Qyteti i Shkupit siguroi mjete në financiare në vlerë mbi 400.000 denarë.

Në Qendrën ditore për persona me pengesa intelektuale mbi moshën 18 vjeç „Poraka”, në lagjen Kapishtec, këtë vjeshtë u hap dhe

u rinovua punëtori për aktivitete sportive dhe kreative. Mjetet financiare për rregullimin e punëtorisë në vlerë 280.000 denarë u siguruan nga Panairi ndërkombëtar i organizuar nga organizata joqeveritare „Dobredojde” – Macedonia welcome centar, si dhe nga Qyteti i Shkupit.



USHTRIM PRAKTIK PËR SHPËTIM „VARDAR 2015”

Në bregun e lumit Vardar, anës urës „Todor Aleksandrov” në lagjen Aerodrom, më 23 prill, u mbajt ushtrim praktik për ballafaqimin me përmbytjet në zonë urbane - „Vardar 2015”. Ushtrimi është në suazat e Programit të Komisionit europian për mbrojtje civile dhe ndihmë humanitare, dhe nën organizimin e Qytetit të Shkupit, i cili është partner në projektin europian për fuqizimin e kapaciteteve lokale për ballafaqimin me përmbytjet „AHELUS”.

Me ushtrimin praktik „Vardar 2015” udhëhoqi Shtabi për mbrojtje dhe shpëtim i Qytetit të Shkupit, dhe morën pjesë të gjitha ndërmarrjet publike nën kompetencat e Qytetit të Shkupit, Brigada për mbrojtjen kundër zjarrit e Qytetit të Shkupit, Sektori për njësi të veçanta i MPB-së, SPB Shkup, Qendra regjionale e Qendrës për menaxhimin me kriza, Njësia vendore e Drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim, Drejtoria për punë hidrometeorologjike, ELEM, EVN, Kryqi i kuq



i qytetit të Shkupit, Shërbimi për ndihmë urgjente mjekësore në territorin e qytetit të Shkupit, ARM, si dhe përfaqësues nga organe të shumë komunave nga Regjioni planifikues i Shkupit nëpër të cilat kalon lumi Vardar. Në këtë ushtrim praktik u angazhuan 185 persona nga shërbimet e qytetit dhe nga institu-

cionet, 50 vullnetarë/studentë të Fakultetit për siguri dhe Institutit për siguri, paqe dhe zhvillim nga Shkupi. Në mënyrë plotësuese, u angazhuan 8 automjete speciale të tipave të ndryshëm, 3 barka shpëtimi, pompë motori, 4 ambulanca, 3 automjete policie dhe helikopter.



SOLIDARITET ME NEPALIN

Këshilli i Qytetit të Shkupit në seancën e 44-të, e cila u mbajt më 30 prill, solli Vendim për dhënien ndihmë viktimave të tërmetit katastrofik në Republikën Demokratike të Nepalit. Me këtë vendim, Qyteti i Shkupit, si shprehje e solidaritetit ndaj viktimave ndau ndihmë në të holla në vlerë një milion denarë.

NDIHMË PËR TË PËRMBYTURIT NË RAJONIN E TETOVËS DHE OHRIT

Pas motit të stuhishëm dhe përmbytjeve që goditën regjionin e Tetovës dhe rrethinat e tij Qyteti i Shkupit dërgoi një ekip për ndihmë teknike dhe mekanizim për pastrimin e pasojave nga uji i vërshuar. Këshilli i Qytetit të Shkupit, në seancën e 52-të që u mbajt më 31 gusht 2015 solli Vendim për dhënien ndihmë viktimave në përmbytjet në Tetovë dhe rrethinat tij. Qyteti i Shkupit, si shprehje e solidaritetit, ndau ndihmë në të holla në vlerë tre milion denarë.

Qyteti i Shkupit dërgoi një ekip dhe ndihmë teknike për ballafaqimin me pasojat e përmbytjeve edhe në Ohër dhe rrethinat e tij, pas reshjeve intensive të shiut që përfshinë vendin tonë në fillim të muajit tetor.

TURNË NDËRKOMBËTAR NË VOLEJBOLL NË RËRË

Çifti i volejbollit Kosiak/Rudol nga Polonia triumfoi në Turneun e gjashtë ndërkombëtar në volejboll në rërë „SATELIT SKOPJE 2015” në konkurrencën për meshkuj që u luajt në terrenet e Plazhit të qytetit „Park” nga data 19 deri më 23 gusht 2015. Në vendin e dytë në këtë turne u klasifikua çifti Kocilianos/Zupanis nga Greqia, kurse vendi i tretë i takoi çiftit të volejbollit Koekelkoren/Van Vale nga Belgjika.

Në Shkup dhe në Republikën e Maqedonisë për herë të parë u mbajt turne ndërkombëtar i një rangu të tillë. Ky turne për herë të parë u gjend në hartën europiane të volejbollit në rërë dhe hyri në kalendarin e Konfederatës së volejbollit europian (CEV), si turne sate-lit – theksoi kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, i cili ndau medaljet për vendin e parë të turneut „SATELIT SKOPJE 2015”.

Në këtë turne morën pjesë çiftet më të mira të volejbollistëve nga Belgjika, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Qiproja, Çekia, Danimarka, Anglia, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Letonia, Norve-

gjia, Polonia, Rusia, San Marino, Serbia, Zvicra, Turqia dhe nga nikoqiri Maqedonia.

Fondi i shpërblimeve për turneun është 8.000 euro. Federata e volejbollit e Maqedonisë është organizator i turneut, kurse Qyteti i Shkupit përkrah financiarisht me 800.000 denarë.



TURNË NDËRKOMBËTAR PËR TË RINJ NË HENDBOLL

Turneu ndërkombëtar i të rinjve në hendboll në sallë „Skopje 2015”, i pesti me radhë u mbajt nga data 13 deri më 19 gusht 2015 në sallën e sportit „Rasadnik” në Kisela Voda dhe në sallën sportive të SHMQSH „Koço Racin” në Gjorçe Petrov. Në këtë turne matën forcat 20 ekipe nga Maqedonia, Serbia dhe nga Mali i Zi, në konkurrencën për meshkuj dhe femra.

Ekipi më i mirë më gjeneratën e vitit 2000 dhe më të rinj (meshkuj) ishte ekipi i KH „METALURG” SHKUP; më i mirë në gjeneratën e vitit 1998 dhe më të rinj (meshkuj) ishte ekipi i KH „METALURG” SHKUP, kurse më i mirë në gjeneratën e vitit 1998 dhe më të reja (femra) ishte ekipi i KH „BAR” – BAR.

Organizator i Turneut ndërkombëtar në hendboll në sallë „Skopje 2015” është klubi i hendbollit „Rabotnički” nga Shkupi. Qyteti



i Shkupit është sponsor i turneut dhe përkrah financiarisht organizimin e tij me 70.000 denarë.

„I PARI DERI NË MAJË”

Më 24 maj 2015 për herë të tretë u mbajt manifestimi për ngjitje rekreative në Vodno „I pari deri në majë”. Në garën e sivjetme morën pjesë disa mijëra garues, në konkurrencën për meshkuj dhe femra në garën tradicionale të alpinizmit, dhe në të njëjtën kohë u mbajt edhe gara e çiklizmit alpinistik dhe rrugor. Në majën e Vodnos, garuesve më të suksesshëm iu ndanë medaljet nga kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski.

„SKOPJE KUP 2015”

Nga data 5 deri më 11 gusht 2015 në disa terrene në Shkup u luajtën garat e Turneut të dytë në futboll të vogël për të rinj në konkurrencën për meshkuj „Skopje Kup 2015”. Këtë vit në këtë turne morën pjesë 32 ekipe nga Maqedonia, Shqipëria, Serbia, Kroacia dhe nga Bullgaria.

Në këtë turne, më i mirë në gjeneratën e vitit 2001 dhe më të rinj ishte ekipi i KF Partizan – Beograd, kurse ekipi më i mirë në gjeneratën e vitit 1999 dhe më të rinj ishte, gjithashtu, ekipi i KF Partizan – Beograd.

Turneun ndërkombëtar për të rinj në futboll „Skopje Kup 2015” e organizoi Shoqata „Skopje kup” dhe Federata e futbollit e Maqedonisë. Qyteti i Shkupit organizimin e këtij turneu e përkrah financiarisht me 100.000 denarë.



SUKSES I MADH NË LIGAT E SHKOLLAVE TË MESME

Rreth 6.000 nxënës nga 28 shkollave të mesme morën pjesë në sistemin e garave ndërmjet shkollave të mesme në Shkup, në vitin shkollor 2014/2015. U luajtën rreth 1.000 gara në hendboll, basketboll, futsal, volejbol dhe qitje në konkurrencën për meshkuj dhe femra, dhe u organizuan edhe gara në badminton, atletikë, ping-pong, karate dhe shah.

Garat finale u luajtën nga data 12 deri më 14 maj 2015 në sallat sportive të SHMQSH "Koço Racin" dhe të SHMQSH "Vasil Antevski-Dren", në final-four e njohur të qytetit. Kampioni i qytetit dhe ekipi që zuri vendin e dytë në zonën e Shkupit morën pjesë në garat finale në nivel shtetëror.

Për organizimin e ligave të shkollave të mesme, Qyteti i Shkupit në vitin 2015 ndau nga buxheti dy milion denarë.

GJIMNAZISTËT MË TË MIRË NË GARAT NË STAMBOLL

Në prill të vitit 2015, gjimnazistët-sportistë më të mirë nga Shkupi garuan me moshatarët e tyre nga Stambolli, në garat e 5-ta me radhë në konkurrencën për femra dhe meshkuj në basketboll, hendboll, futsal, si dhe në volejbol në konkurrencën për femra.

- Kjo është pjesëmarrja e pestë e gjimnazistëve-sportistë më të mirë nga Shkupi në qytetet më të mëdha të regjionit. Deri tani kemi marrë pjesë në Lubjanë, Zagreb, Beograd, Sofje, dhe tani jemi në Stamboll. Qyteti i Shkupit shënon sukses të madh në afirmimin e sportit të nxënësve të shkollave të mesme dhe kontribuon që një numër gjithnjë e më i madh i nxënësve të merren me sport – tha kryetari Koce Trajanovski, në vizitën në Stamboll.



TURNE NË FUTBOLL TË VOGËL „8 SEPTEMVRI”

Vendin e parë në turneun tradicional në futboll të vogël „8 Septemvri” që u organizua me rastin e Ditës së pavarësisë, e fituan futbollistët e ekipit të Tavernës „Doma”. Në terrenin sportiv në lagjen Triangla, Maxhari, matën forcat mbi 65 ekiye nga Shkupi dhe nga komunat e Maqedonisë.

Organizatori i turneut „8 Septemvri”, që u mbajt për herë të tetë, është shoqata „BA TU TA SPORT”, kurse Qyteti i Shkupit e përkrahu organizimin e tij me 150.000 denarë.



IKAS 2015

Dushan Stojiljković nga Serbia triumfoi në edicionin e 47-të të manifestimit ndërkombëtar „Slalom në kanu linden – IKAS 2015”, që u mbajt nga data 4 deri më 5 prill në korsinë e Matkës.

Në këtë edicion të IKAS morën pjesë 150 garues nga Maqedonia, Sllovenia, Kroacia, Serbia, Greqia, Turqia, Ukraina, Kazakistan, Lituania, Mali i Zi dhe nga Bullgaria. Qyteti i Shkupit për organizimin e IKAS ndau rreth 180.000 denarë.



UNIFORMA TË REJA PËR ORKESTRËN FRYMORE TË QYTETIT

Anëtarët e Orkestrës frymore të qytetit këtë vit morën uniforma të reja.

- Uniformat e orkestrës frymore të qytetit janë kreacion i shtëpisë së modës „Elena Luka” dhe janë adekuate për këtë lloj orkestre. Kjo orkestrë merr pjesë në të gjitha manifestimet në Shkup, për shënimin e datave të rëndësishme të qytetit dhe festave shtetërore, në lokacione të ndryshme – sheshe, qendra tregtare, parqe... Orkestra frymore e qytetit funksionon në suazat e Qendrës kulturore rinore, kurse qyteti i Shkupit për punën e saj këtë vit ndau 1,5 milion denarë. Për blerjen e uniformave dimërore Qyteti i Shkupit shpenzoi 400.000 denarë – theksoi kryetari Koce Trajanovski,



në promocionin e uniformave të reja, që u mbajt më 10 tetor, në Qendrën tregtare të qytetit.

U ZBULUA PLLAKA PËRKUJTIMORE E JURIJ GAGARIN

Më 16 prill 2015 në parkun „Maqedonia” u zbulua pllaka përkujtimore e kozmonautit Jurij Gagarin.



- Në emër të qytetarëve të Shkupit dua t'i shpreh mirënjohjen ambasadës së Federatës Ruse në Republikën e Maqedonisë dhe personalisht ambasadorit Oleg Scerbak për përpjekjet e tij të fuqishme, kryeqytetit maqedonas t'i dhurojë një monument përkujtimor të personit, i cili është simbol botëror për tejkalimin e kufijve të arritjeve dhe mundësive njerëzore. Më 12 prill të vitit 1961 kozmonauti Jurij Gagarin doli nga hemisfera e tokës dhe pas gjysmë ore qëndrimi në hapësirën kozmike u kthye në tokë. Që atëherë filloi të shkruhet një faqe e re në historinë e njerëzimit. Edhe sot Gagarin është simbol i guximit, prosperitetit teknologjik dhe i hapit të parë jashtë kufijve të rruzullit tokësor. Prandaj, qytetarët e Shkupit me kënaqësi kremtojnë ditën e fluturimit të njeriut të parë në gjithësi dhe pranojnë gjithashtu me kënaqësi këtë donacion – theksoi kryetari Koce Trajanovski, në zbulimin e pllakës përkujtimore.

Në parkun e Frankofonisë, afër Parkut të qytetit, më 10 mars të këtij viti u vendos pllakë përkujtimore për nder të ushtarëve francezë që humbën jetën në Maqedoni në Luftën e parë botërore. Vendosija e kësaj pllake përkujtimore është pjesë e aktiviteteve të ambasadës franceze në Republikën e Maqedonisë, për shënimin e 100-vjetorit të Luftës së parë botërore.

- Kjo pllakë përkujtimore do të jetë përkujtim për qytetarët e Shkupit dhe të Maqedonisë për guximin dhe sakrificat e ushtarëve francezë të cilët dhanë jetën e tyre në Luftën e parë botërore, si dhe në betejën e Shkupit, e cila u zhvillua nga data 29 deri më 30 shtator të vitit 1918 – tha kryetari Koce Trajanovski, në zbulimin e pllakës përkujtimore.



PËRFAQËSIM ME SUKSES NË „DITË TË HAPURA – JAVA EUROPIANE E REGJIONEVE DHE QYTETEVE”

Qyteti i Shkupit u përfaqësua në mënyrë të suksesshme në edicionin e 13-të të „Ditë të hapura – Java europiane e regjioneve dhe qyteteve” që u mbajt nga data 12 deri më 15 tetor në Bruksel. Në suazat e këtij eventi tradicional, Qyteti i Shkupit organizoi ditën e hapur që u mbajt në Misionin e Republikës së Maqedonisë në Bruksel, ndërsa mysafirët e pranishëm dhe pjesëmarrësit kishin mundësi të njihen me Shkupin, mundësitë e tij, kuzhinën tradicionale maqedonase, verën dhe muzikën.

Në këtë event, qytetet dhe regjionet nga Europa prezantohen para publikut dhe këmbëjnë eksperiencat për zhvillimin ekonomik dhe përfshirjen sociale, partneritetin publik-privat, bashkëpunimin ndërkufitar, për inovacionet regjionale dhe zhvillimin ekonomik lokal.

Në suazat e „Ditë të hapura – Java europiane e regjioneve dhe qyteteve”, kryetari Koce Trajanovski nënshkroi „Karta e gjelbër digjital” (Green digital charter).

– Qyteti i Shkupit është qyteti i 48-të në Europë që ka nënshkruar këtë Kartë dhe qyteti i parë nga vendet e Ballkanit perëndimor. Me nënshkrimin e kësaj Karte, qytetet obligohen, nëpërmjet bashkëpunimit me qytetet-nënshkruese dhe me zbatimin më të madh të



teknologjive informatike dhe komunikimit, të ndërmarrin masa për mbrojtjen e ambientit jetësor dhe për rritjen e efikasitetit energjetik – theksoi kryetari Trajanovski.

SAMITI I KRYEQYTETEVE 2015

Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski mori pjesë në Samitin e kryeqyteteve të Europës qendrore dhe juglindore Europa 2015, që u mbajt më 23 prill në Beograd. Në Samit morën pjesë edhe Aleksandar Vučić, kryeministër i Serbisë, Sinisha Mali, kryebashkiaku i Beogradit, Ivo Komisiq, kryebashkiaku i Sarajevës, Milan Bandić, kryebashkiaku i Zagrebit, Zoran Janković, kryebashkiaku i Lubjanës, si dhe përfaqësues nga Vjena, Varshava, Athina, Budapesti, Sofja, Tirana dhe nga Podgorica.

Ky samit është mundësi e shkëlqyer për avancimin e bashkëpunimit ndërmjet regjioneve dhe kryeqyteteve, nxitjen e bashkëpunimit ekonomik, këmbimit ekonomik dhe investimeve, si dhe promovimin e shembujve më të mirë të infrastrukturës, zhvillimit urbanistik dhe zhvillimit të shërbimeve publike dhe komunale.



TRAJANOVSKI NË VIZITË NË STAMBOLL

Më 20 prill 2015 në suazat e vizitës në Stamboll, Turqi, kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski dhe delegacioni i Këshillit të Qytetit të Shkupit realizuan takim me kryebashkiakun e Qytetit të Stambollit, Kadir Topbas.

– Në këtë takim diskutuam për çështje të lidhura me komunikacionin rrugor, urbanizmin, hortikulturën, ndërtimtarinë – për të gjitha fushat që janë nën kompetencat e qeverisjes vendore. Pikërisht qeverisja vendore është një nga mundësitë më të mira për bashkëpunimin ndërmjet qyteteve, sepse problemet me të cilat ballafaqohen qytetet, pavarësisht nga vendi, janë të njëjta – theksoi kryetari Trajanovski, pas takimit.





Baskerfest 2015



Roje turistike



Valle pa kufi



Nata e bardhë



Vino - skop 2015



Pivolend 2015



Tingujt e çarshisë



Vera e Shkupit 2015